


**BAHRI
MYFTARI**

Maturantët

dramë

844-2
N1 PP

Bahri
Myftari



Maturantët

dramë



SHTËPIA BOTUËSE
«NAIM FRASHËRI»

PERSONAZHET

EDA	— <i>nxënëse</i>
AŠTRITI	— <i>nxënës</i>
BESNIKU	— «
RÖLANDI	— «
AGIMI	— «
FATOSI	— «
DRITA	— <i>nxënëse</i>
VJOLLCA	— «
LUMI	— «
BARDHI	— <i>mësuesi kujdestar</i>
VALTERI	— <i>i ri</i>
NJË DJALE	

— Nxënës dhe nxënëse të tjera —

Pamja e parë

*Në klasë Rolandi është duke rregulluar
flokët dhe duke fërshëlyer një melodi.*

Astriti — Të lutëm, a nuk ka mundësi?

Rolandi — Na plase. Ke gati njëzet e katër orë
që vetëm mediton, vetëm flet me vete.

Astriti — Më lër të qetë, Roland!

Rolandi — Deri kur?

Astriti — Ja edhe një muaj e pastaj mirupafshim.

Rolandi — Pastaj shoku Astrit në universitet,
ndërsa shoku Roland pikëpyetje... Megjithëse po kaq pikëpyetje të kanë rrëthuar
edhe ty, vëlla.

Astriti — Po atëherë ç'më ngacmon?

Rolandi — Mallkuar kush vret èndrrat e shokëve!

Astriti — Mos u tall.

Rolandi — A s'është èndrra jote për të vazhduar
për filozofi? (*Bën me dorë nga Astriti.*)
Më prit, universitet i dashur!

Astriti — Brenda javës dy shtata.

Rolandi — Ajo shtata që more në fizikë nuk më shqetësoi shumë, po ajo që more në marksizëm m'u duk shumë e rëndë, me gjithëse, prapë se ç'kam një parandjenjë që, edhe sot po të ngrihesh, shtatë merr.

Astriti — Po të bredhësh deri në dhjetë të darkës, ta merr mendja.

Rolandi — Kulmi i ndershmërisë! Kulmi i naivitetit, po brenda vetes kërkon ta gjesh të keqen! Po të pyes: mbrëmë në lulishte «Rinia» mësuesi i marksizmit me kë po pinte kafe... C'pate? E, pra, përgjigju.

Astriti — Me të atin e Edës.

Rolandi — Të Edës, shoqes sate më të ngushtë. (Ironik) E pra, lidhi gjérat, Astriti.

Astriti — C'do të thuash?

Rolandi — Dua të them se jeni në finish, në fund, kur apo kanë filluar bërrylat, ndërhyrjet...

Astriti — Ata kanë të njohur dhe mund të pinë...

Rolandi — Jemi në stinën që të gjithë, janë e ku janë, dalin kushërinj të parë e më tepër. Po ti nuk ke sy dhe je shurdh. Rreth shtatave të tua kush bëri zhurmë më tepër, kush kritikoi më tepër e më rrëptë, sipas gjuhës sate? Pikërisht ajo Edë... prit... C'do të thuash, se jeni shokë të ngushtë, se kenë hyrje e dalje familjare, të gjitha këto tani nuk kanë asnjë vlerë. Dihet edhe dëshira e saj për të vazduar për filozofi. Atëherë cili është rivali i saj këtu në klassë?... Astriti! Vëçse për filozofi nuk vijnë dhjetë apo njëzet të drejta studimi. Bëje

opinion rënien e Astritit, cirru se gjoja të vjen keq për shtatat e tij e, nga ana tjetër, dil vetë në krye. Rrëzohet Astriti e ngrihet ajo...

Astriti — Roland!

Rolandi — Çudi, ende nuk të ka thënë (*Imiton*)
«Ti, Astrit, meqenëse je nga fshati, zgjidh një degë që t'u shërbesh lopëve, kuajve...»

Astriti — Eda nuk është si ti, Roland!

Rolandi — (Qesh.) Të ka verbuar pamja e saj, më duket. Mos vallë nën maskën e shoqërisë...

Astriti (*E mbërthen.*) Ti nuk je në vete, Roland!
(*I prekur nga gjesti i ulët, duket i pezmatuar.*)

Rolandi — Titi, s'më mbetet hatri, unë dua vëtëm një gjë, dua që ti të fitosh. Kemi folur një herë bashkë. Unë bisedova edhe me Valterin.

Astriti — Mos ma zër në gojë atë.

Rolandi — Ai ka babanë në komitet; s'e mban mend kur erdhi me atë ekipin e kontrollit, edhe drejtori rrinte gatitu përparrat atij?
Ai ka në dorë të drejtat e studimit.

Astriti — C'më duhen këto mua!

Rolandi — Valteri më premtoi...

Astriti — Të thashë mos-ma zër në gojë atë tyryfyl.

Rolandi — (Qesh.) Tyryfyl, epiteti që i ka ngjitur Eda atij!

Astriti — Edhe mirë ia ka bërë.

Rolandi — Ashtu?! I isha betuar Valterit se do t'ia

mbaja tē fshehtën që më ka treguar, por ja që para teje nuk mundem... Si, si e quan e mira Edë, e singertë, e bukura Edë, Valterin?

Astriti — (Nervoz) Tyryfyl, rrotë, idiot...

Rolandi — Kurse ty tē quan shok. Ndërsa unë po tē them se ajo ty tē mban thjesht si çadër. Valterin po, atë e ka shumë e më shumë.

Astriti — Ajo nuk e duron dot, ai i qepet si ferrë.

Rolandi — Ti nuk ke sy, mirë tē kam thënë. Ajo e ka dashur atë. A më kuption, Eda dhe Valteri...

Astriti — Mjaft! S'po e kuption se po tē duroj si tepër, ç'dreqin ke që dërdëllit kështu pér tē!

Rolandi — Pér shoqen tënde tē ngushtë.

Astriti — Shoqe e kam.

Rolandi — Veçse është ajo që po tē punon qindin.

Astriti — Nuk lejoj asnijë shpifje pér tē.

Rolandi — Shpifje! Unë shpifkam? Mëso, pra, se në librin e saj tē letërsisë është një letër e Valterit.

Astriti — Çfarë??

Rolandi — Letër e Valterit, dhe çfarë letre do tē jetë, besoj se...

Astriti — Mbylle!

Rolandi — E kam parë me sytë e mi. (Astriti e shtyn.) Në djall shkofsh me gjithë tē! S'kam ç'të bëj më tepër... (Duke ikur.) Veçse dije, sinqeriteti yt ndaj saj është i tepërt.

Ti s'do ta kuptosh. Je në muajin e fundit të shkollës, Astrit, ku çdo ditë vendoset fati i së ardhmes. (Bën të ikë.)

Astriti — Roland... pa qetësuhu...

Rolandi — Unë apo ti...

Astriti — A e di se ç'më the?

Rolandi — Nëse ajo letër nuk gjendet në librin e saj, më pështyj, më shaj, më bëj ç'të duash.

Astriti — Landi... Po mirë... ku... si... si e pe let-rën?

Rolandi — Ti s'do ta besosh, Astrit. Rastësish, dje, në pushimin e gjatë, unë...

Astriti — E pabesueshme! Si ka mundësi që ajo të më kundërvihet, si ka mundësi që të shkojë me një tip që...

Rolandi — S'ke ç'bën, ja që kjo është e vërteta!

Astriti — Kulmi! Të tjera më thotë mua e të tje-ra bëka! Të jetë e vërtetë? (*Një grup nxë-nësish hyjnë duke qeshur. Ata ndjekin nga pas Fatosin, i cili ka një bllok në dorë.*)

Zëra — Na e lexo, na e lexo. (*Ai ngurron, shokët e kalojnë bllokun dorë më dorë e ai përfundon në dorën e Rolandit.*)

Zëra — Lexoje, lexoje.

Agimi — (*I del përpara Fatosit, që sulet me rrëm-bim dhe me zë të lartë flet anglisht.*)

Friends, poet is going mad. Shokë. poeti po shkallon. (*Të tjerët qeshin.*)

Fatosi — Përkundrazi, jam tepër i qetë. Desha t'jua lexoj në mbrëmjen e maturës, nuk ju pritet? Lexojeni.

Drita — Lexoji, Roland.

Rolandi — (Me ironi) Si urdhëron, Drita. (Nis e lexon.)

Në mes tonë një shoqe kemi,
vajzë e thjeshtë me sy boj' qelli.

Zëra — Drita!

Rolandi — Janë dy miq, a i njihni?

Si dy gonxhe trëndafili,
bashkë gjithmonë, të pandarë;
të dy rrinë në bankë të parë.

Zëra — Eda dhe Astriti.

Rolandi — (lexon) Po një tjetër kush e gjen?

S'di gjë tjetër vec dy fjalë:
përemrin «unë» dhe foljen «jam».

Drita — Ti vetë je. Të lumtë, Fatos!

Rolandi — Përkundrazi, ja ku po ta them, Fatos,
ti ke dëshuar pa hedhur hapin e parë.

Drita — Shaka e trashë.

Rolandi — Kurse ti je e hollë, tepër e hollë, dy
vargje dhe po të bëjnë të fluturosh. Unë
për vete jam...

Eda — Ashtu, siç të ka tipizuar Fatosi.

Rolandi — Nga ti, Eda, vetëm sulme pres. Mos ke
ndër mend ta sjellësh përsëri babanë tim
këtu? Kishe nevojë të të njihnin edhe në qy-
tetin tim se ti je kujdestarja e klasës e të
njohën.

Lumi — Uaaaaa!

Rolandi — Ç'pate, Lumi?

Lumi — Pse, Eda ta solli babanë ty?

Besniku — Babanë ia pruri koka... Apo jo, Roland?

Roland — Dëgjojeni këtë, dëgjojeni, se ky e ka me kitarë.

Agimi — Pasi hedh sytë nga Astriti: Shokë, di-kujt i janë mbytur gjemité.

Astriti — (Agimit) Kurse ti nuk di të bësh humor.

Një zë — Mësues Bardhi! (*Hyn Bardhi, pas tij Vjollca e Mira.*)

Bardhi — (Me humor) Uluni, uluni, ose ngrehuni të gjithë në këmbë. Gëzimet nuk priten ulur. Vazhdo, Vjollca.

Vjollca — Porsa u kthyem nga komiteti i rinisë. Propozimi ynë për të bërë një muaj aksion pas provimeve u miratua dhe u vendos që aksionin ta bëjmë në minierën e Pyllasit.

Fatosi — Unë kam qenë një herë atje. Është një vend i mrekullueshëm, me burime, me pyje, me quell të pastër.

Roland — Si sytë e Dritës.

Fatosi, — Jo, Landi. Edhe më të pastër, tamam si ajo pasqyra që mban ti në xhep.

Besniku — Kam unë një vërejtje.

Roland — Vëri vulën ti.

Besniku — Rri i qetë ti, e kam me Fatosin. Duhet të jesh realist, Fatos, minerali nuk nxirret nën qiełl, por nën tokë.

Mira — Të kam thënë, Fatos, ti do të bëhesh një poet i mirë vetëm po të të ndjekë krijimtarinë një kritik i mirë siç premtón të bëhet Besniku.

Bardhi — Edhe po të ketë lexues kaq të mirë sa ju. Jo, vlerësojeni edhe këtë portret të

thjeshtë. Kam bërë Fatosin minator, besoj diçka kam arritur. (*Merr fletën ku ka skicuar portretin, e vendos në dërrasën e zezë dhe me humor largohet.*)

Lumi — Uaaaaaaa, sa shpejt. (*Të gjithë afrohen me gjalléri në dërrasën e zezë, qeshin me njëri-tjetrin e largohen, në skenë mbeten vetëm Eda, Astriti dhe Rolandi.*)

Eda — Astrit, do të vish?

Rolandi — Mos ke ndër mend ta qerasësh, se raste ke dhe i ke të shumta.

Eda — Unë? Ju po, jeni dy djem dhe keni një vajzë në mes.

Astriti — Mos na bëj për të qeshur.

Eda — Çfarë flet, Astrit?

Astriti — Çadër, çadër më thirr.

Eda — Astrit!

Rolandi — O-o-o, fillo të përlotesh tani!

Astriti — (Rolandit) Ti mbaj vendin e mos fol. Kështu pra, shoqja ime e ngushtë, Eda. Pra, qenka e kotë, e kotë; edhe pse po mbarojmë shkollën e mesme, paskemi mbetur fëmijë. Vallë në ç'moshë mund të zësh miqësi me një njeri?

Eda — Ne të dy jemi miq, Astrit.

Astriti — Paskemi kujtuar, po s'paskemi qenë as gjë, O, më fal, unë paskam qenë thjesht një çadër.

Eda — Unë të kam shok, mik dhe në shtëpi prindërit e mi të presin si birin e tyre.

Astriti — Edhe në shtëpinë time flasin për ty siç flasin për time motër...

Eda — Po atéherë çfarë ka, unë të kam çmuar
dhe të çmoj.

Astriti — Veçse më keni dhënë çmimin e çad-
rës... Kaq vlej?

Rolandi — Jo... Më shumë se një çadër.

Eda — Astrit, fol të lutem, ti ke ditë që e
mban kokën mënjanë.

Astriti — Kurse sot e tutje do të shikoj përbal-
lë, veçse jo ashtu siç të kam parë, çiltër
dhe pastër. Sytë këta do të jenë, por men-
dimi, mendimi im do të jetë ashtu siç
e meriton. Shumëkush mallohet kur kujton
vitet e shkollës së mesme...

Eda — Edhe kanë të drejtë.

Astriti — Mos më ndërpri. Shoqëri e pastër, e
singertë, e gjëzuar.

Eda — Po tamam kështu është.

Astriti — Të thashë mos më ndërpri.

Eda — Do të të ndërpres. Nuk po më pëlqen
toni i zërit tënd me të cilin po i pohon kë-
to gjëra kaq të bukura të këtyre viteve.
Duket sheshit se ti...

Astriti — Që unë nuk i besoj. (*Qesh me ironi.*)

Prapë unë qenkat fajtori. Unë që isha të-
rësish i dhënë pas këtyre gjërave kaq të
bukura. Dhe, ngaqë isha i tillë, nuk pata
mundësi të zbuloj me kohë deri ku arrin-
te egoizmi yt.

Eda — Unë egoiste?! Ndaj kujt? Ndaj teje, As-
trit?

Rolandi — Po pse, ndaj kujt, ndaj meje? Unë jam...
Ai që përbën rrrezik për ty është Astriti.

Eda — Astriti rrezik për mua?

Rolandi — Dihet dëshira jote për të vazhduar për filozofi. Dhe po këtë dëshirë ka edhe Astriti.

Eda — Shumë mirë. Pastaj as unë, as Astriti, s'e kemi shprehur dhe s'e mendojmë që o në filozofi, o rashë e vdiqa. Ka plot degë të tjera.

Astriti — Po! Ka të tjera sa të duash. (*Imiton.*) «Unë për vete të shkoj atje ku dua, kurse të tjerët... Ka degë të tjera plot.»

Eda — Unë nuk u shpreha kështu, më duket se fola shumë qartë.

Astriti — Fjalët rrrodhën të pastra, por, kur mendon se qfarë fshihet në to, të zë tmerri.

Eda — Unë nuk di të fsheh, nuk jam mësuar me të fshehur.

Astriti — Veçse gjérat flasin krejt ndryshe.

Eda — Cilat gjëra?

Astriti — Po e zë që nga kritika që më bëre për shtatën.

Eda — Moš doje të të lavdëroja ?

Astriti — Jo, më qortove; po më kritikove me shumë zhurmë. E, ku ka zhurmë, nuk ka sin-qeritet, dashamirësi.

Eda — Astrit!

Astriti — Po, po.

Eda — Shoqëria dhe miqësia kanë nevojë përfjalë zemre dhe jo për nerva.

Astriti — Kur ke të bësh me miq e shokë.

Eda — Je i bindur se unë nuk e meritoj këtë?

Astriti — Roland, dil pak jashtë.

Eda — Jo, Roland, mos läviz.

Astriti — Kur është një i tretë, e fshehta mund të fluturojë e këtë kërkesë unë jam i detyruar të ta plotësoj. Edhe ndaj shoqes Eda ndiej një detyrim...

Eda — Ky i treti s'është i tretë sidokudo, por është shoku ynë, kurse për të fshehtat të thashë pak më parë që s'jam mësuar me to. Sa për detyrimin që paske ndaj meje, të faleminderit, unë s'dua që miqësisë t'i vë një barrë të tillë... Prandaj fol.

Astriti — Më jep librin e letërsisë, shpejt, ma jep tanë, dhe nëse aty nuk ka asgjë, unë para syve të tu do të bëj gjë tjetër. (*Astriti merr shpejt librin e Edës dhe hap kapakun, nxjerr një letër me zarf. Letra bie në dysheme, Astriti bëhet gati ta marrë.*) Jo, merre ti.

Eda — C'është kjo?

Astriti — Vula e mungesës së sinqueritetit tënd.

Eda — Kjo letër nuk është për mua.

Astriti — Nga ti ra, nga libri yt. Mos vallë do ta mohosh? Mos vallë do të thuash se ra prej xhepave të mi? Roland, e pe? Rolandi e pa.

Rolandi — E pashë!

Astriti — E pe të bjerë nga xhepat e mi?

Rolandi — Jo, ra nga libri i saj.

Astriti — Merre, pra.

Eda — (*E cila nuhat diçka. E nervozuar.*) Nuk është imja të thashë, nuk kam pasur një gjë të tillë.

Astriti — Ikim, Roland, ikim. Nervat s'janë gjë

tjetër veçse një mbulesë pér të fshehur të vërtetën... Ikim. (*Dalin*).

Eda — (*Vetëm*) Ç'ishte tërë kjo?! Vallë si e durova? O nënë, o nënë, kush ma ka bërë këtë peshqesh? (*Hyn Vjollca*.)

Vjollca — Përse mendohesh, Edë. Ndërsa përjashta pranvera po na thërret. Kanë çelur mimoza dhe po fryn një fllad. Këtu nuk u dashka poeti, po krahу i fortë i kovaçit. (*I bie tavolinës*.) Ngreje kokën!

Eda — Më lër, të lutem, Vjollca.

Vjollca — (*Sheh letrën në dysheme*.) E kujt është kjo letër? (*Lexon*.) Merr Eda Kodra... Dërgon... s'ka emër. Ç'është ky i paemër?

Eda — E pra, ç'është?.

Vjollca — Merre, merre.

Eda — Hiqma nga sytë, grise.

Vjollca — Nuk bëhesh fare kurioze?!

Eda — Më shumë më shqetëson se cili ma kishte vënë në librin e letërsisë.

Vjollca — Mos është ndonjë shaka miqësore. E hap dhe lexon). Qenka letër dashurie! Të betohem.

Eda — Si, si?

Vjollca — (*Lexon*.) Eda, u bënë kaq kohë dhe më në fund vendosa t'ju dërgoj këtë letër si provë të ndjenjave që ushqej pér ty. Letra nuk ka shumë fjalë, por ka shumë mall.

Eda — (*E ndërpret*.) Idioti!

Vjollca — (*Vazhdon*.) Në dashurinë time, në ndjenjat e mia pér ty, ka vetëm...

Eda — (E ndërpret.) Marrëzi! Mjaft, të lutem! Vjollca.

Vjollca — (Lexon në fund të letrës.) Pa shih kush na qenka! Valter M. Mos është ai tipi që vjen e rri përpara shkollës?

Eda — Tamam ai.

Vjollca — (Lojë) Të them të drejtën, një ditë më erdhi keq për të. Filluam hartimin e derisa e mbaruam atë, ai ishte mbërthyer te grilat. Hajde këmbëngulje, thashë me vete. E bëkish për ty atë sakrificë!

Eda — Mos u tall.

Vjollca — S'po tallem. Dhe ti nuk do ta besosh. A s'është kjo një provë e fortë prej tij? Mos do ti që ai të hidhet nga kati i tretë? Të jem si ti, unë këtë bëj. E bie këtu në katin e tretë dhe i them: Po më deshe mua, hidhu!

Eda — Ja u hodh me gjithë mend!


Vjollca — Po të ketë aq mend, le të hidhet, t'i shkojë aventurës gjer në fund!...

Eda — Një ditë desh erdhi me të vërtetë, po nuk e la roja te porta.

Vjollca — Më duket se e ka gjetur muhabetin edhe me rojën, sepse Rolandi na e paska kushëri këtë.

Eda — Cili është ky kushëri që na u zbulua në fund të katër vjetëve?

Vjollca — Rëndësi ka që ai kushëri gjeti kushëririn dhe Landi e do aq shumë, sa ka filluar t'i ngjajë këtij. V. Mësë edhe në veshje, dhe kudo.



Eda — Më kujtohet njëherë, në fund të korridorit kishte nxjerrë një pasqyrë dhe shikohet e krihej.

Vjollca — Cili?

Eda — Rolandi!

Vjollca — Prite tanë kur të thotë ndonjë ditë: «Unë, unë jam edhe më i bukuri!» Moj, edhe Astritin e kam parë unë të bëjë një veprim të tillë. Qyqja, mos është sëmundje ngjitet se kjo e pasqyrës!!

Eda — Astriti, Astriti...

Vjollca — Si thë?

Eda — (*Merr letrën.*) Thashë se kjo letër duhet grisur, duhet djegur.

Vjollca — Mos u ngut, sikur the se këtë letër ta kishin futur në librin e letërsisë. Kush e ka futur, ta gjejmë. Ndërsa atij tipi preja shkurt. Mos i lër shteg...

Eda — S'i kam lënë shteg. Vjollca. Ja si ndodhi fije e pér pe...

Fiken dritat dhe jepet veprimi në retrospektivë

Valteri — (*Në pritje*) S'po vjen, mos e ka pushim orën e parë. Dreqi ta hajë, çfarë fati! Pusho. (*Kalon Mira, ai e ndjek me sy. Pas pak vjen Eda*) Erdhi, erdhi.

Eda — Ua!...

Valteri — U trembe?

Eda — Të lutem.

Valteri — S'është hera e parë që shihemi, apo jo?

Eda — Nuk është hera e parë, por dua që kjo të jetë hera e fundit, hapu...

Valteri — Nuk dua dhe jo se s'di të mbaj ndonjë ligjëratë të gjatë...

Eda — Edhe të shkurtër s'është nevoja.

Valteri — C'sjellje! Je në një shkollë ku shumica e nxënësve janë fshatarë dhe shoh që ti paske rënë në psikologjinë e tyre.

Eda — U marrsh të keqen.

Valteri — Si the?

Eda — Do të bësh mirë të shikosh psikologjinë tënde!

Valteri — Kam një teze unë, ajo përdor edhe shprehjen «të marrsha të ligat...»

Eda — Nuk më intereson, largohu.

Valteri — Vërtet ti je vajzë drejtori, por s'duhet t'i shikosh të tjerët nga maja e malit, se, edhe ne jemi njerëz, bile babanë e kam...

Eda — Aq më bën!

Valteri — Desha të të them se ne si familje...

Eda — Keni edhe ndonjë tjeter që bërdh rrugëve si ti.

Valteri — Po më fyeni rëndë.

Eda — Sjellja jua e meriton edhe këtë.

Valteri — (Ndërron ton.) Jam më i madh e duhet të të jap një këshillë... Pse qesh. Atje në klasë ti ke një djalë.

Eda — Klasa ka pesëmbëdhjetë djem.

Valteri — Me njërin ti... Nejse, nuk zgjidhet shoku i jetës moshatar dhe aq më shumë kur ky është nga një fshat.

Eda — Unë i kam shokë të gjithë. Kur të vijë di-

ta tē vendos, nuk do tē jetē nevoja pér kë-shilla tē tilla. (*Bën tē ikë.*)

Valteri — Dëgjo këtu, dëgjo.

Eda — Nuk kam ç'të dëgjoj dhe mos më dil më përpara.

Valteri — Kam besim te ti se do tē më kuptosh.
Do tē shihemi e do tē takohemi prapë.

Eda — Kurrë! Me ty s'më lidh asgjë. (*Ikën.*)

Valteri, — (*Vetëm*) Natyrisht, s'ka si tē thotë «do tē shihemi». Fillimi është i vështirë. E njoh unë kokëfortësinë e vajzave. Me këtë do ta kemi pak tē vështirë. Kjo e mban mendjen tek ai buzënjomi që ka në bankë.

Fiken dritat. Veprimi po në tablon e parë.

Eda — Kjo është e tëra, Vjollcë.

Vjollca — Shumë mirë ia ke bërë, Eda, i duhet vënë kufiri te thana!

Eda — As çaj kokën pér tē, por shqetësohem se kush ka mundur ta sjellë këtë paçavure (*Tregon letrën*), gjer këtu në klasë. Megjithëse pér dikë dyshoj.

Vjollca — Dyshon! Pér kë?

Eda — Pér atë gjoja kushërin e tij... Rolandin...

Vjollca — Rolandin!

Eda — Si tē tē them.

Vjollca — Tē njoftojmë mësues Bardhin!

— *Fundi i pamjes së parë* —

Pamja e dytë

Veprimi zhvillohet në një dhomë, në konvikt, Aty janë Besniku, Astriti, mbi krevatin e tij, disi i mërzitur. Fatosi dhe Agimi, nën melodinë e kitarës, së cilës i bie Besniku, vallëzojnë. Fatosi është disi i ngathët.

Agimi — Një dy, një dy... (Fatmirit s'po i ecën, Agimi e lë dhe si me shaka i thotë.) No, no, You can not learn at all = jo, jo, ju nuk mund të mësoni aspak.

Fatosi — (*I pezmatuar*) Domethënë, unë në mbrëmjen e maturës do të rri kështu si hu, kurseti, ti... (*Bën të rrotullohet e gati bie.*)

Besniku — Fatos, me ç'shoh unë, ti ke pér të mësuar të vallëzosh kur të shkosh në universitet!

Agimi — (*Me humor*) Më mirë, se do të ketë edhe një shans tjetër.

Fatosi — Çfarë?

Agimi — Rrezik që të jesh i vetmi student që s'di të kërcejë.

Fatosi — Kulmi! Me gjithë mend?

Agimi — (*Ngacmon Astritin që nuk përzihet.*) Si thua ti, Hamlet? Ç'më rri kështu, për kokën tënde, sikur të kesh tërë hallet e kontinentit mbi shpinë!

Astriti — Nuk kam nevojë për humor.

Fatosi — E ka mbérthyer keq shqetësimi për degën që ka zgjedhur. Çuditem, Astrit, pse të pëlqen kaq shumë filozofia?

Besniku — Të gjithë për letërsi nuk do të shkojnë, Fatos.

Fatosi — Mua, për vete, pas letërsisë do të më pëlqente ndonjë degë që ka të bëjë direkt me prodhimin e të mirave materiale. Agronomi...

Agimi — Edhe filozofia duhet, ajo, si të thuash, i bën filozofinë qumështit.

Besniku — Mjerë ajo, po të mjaftohej me kaq, se në këtë punë më e shkathët se filozofia del stomaku.

Agimi — (*I qeshur*) Tërhiqem! Po dal.

Fatosi — Po të lashë unë... Besnik. (*Besniku i bie kitarës. Ndërkohë hyn Rolandi, që ia shkrep të qeshurit që te dera, kur shikon shokët të vallëzojnë.*)

Roland — Na ishte se ç'na ishte, na ishin dy gjela që mundeshin në fushë të sportit. Hiqu mënjanë, Fatos, s'është për ty muzika; ka ndonjë bejte për ty? Kurse ti, Agim, mbathja për në bibliotekë, shko qorrohu në ata fjalorët e trashë të anglishtes.

Besniku — Po ti?

Roland — Unë, unë do të rri këtu, pranë teje, të

mësoj kitarën, apo s'e qan ti... vetëm me dy tela!

Agimi — S'ke pse ta mësosh prej Besnikut ti, ti e ke maestron, ke atë kushërin tënd.

Besniku — Ore, vërtet, ç'dëgjoheshin ato melodi këtu mbrëmë?

Agimi — Pyet Astritin, se ky i dëgjoi për dy orë tresht.

Astriti — Ç'do të thuash?

Besniku — Megjithatë, ato melodi...

Rolandi — (Besnikut) Ke ndonjë gjë ti me atë kushërin tim? Në qoftë se ke, hajde thuhaja në sy; pas pak këtu e ke.

Agimi — Pse, ha njerëz ai kushëri yt?

Rolandi — Hajde, pra.

Besniku — Ja ku po ta them se, po erdhi dhe i ra kitarës si mbrëmë, dije se do ta flakim përjashta.

Rolandi — Kë?

Besniku — Atë dhe këdo që i mban ison atij.

Rolandi — Mos ke bërë mend të mos dalësh më jashtë kangjellave?

Agimi — (Ironik) Kasus Klei!

Rolandi — Çfarë the?

Agimi — Fola anglisht..

Rolandi — Mendjemadh!

Agimi — Pasqyrëli!

Besniku — Paçqyrën ia gjen në xhep edhe Astritit!

Astriti — Më lini rehat, ç'doni nga unë!

Besniku — Bashkë dje nisëm një bisedë dhe e lamë përgjysmë.

Astriti — Ti kërkon të ngjitësh një xham që u bë copë.

Besniku — Astrit!

Astriti — Ke dëgjuar atë Edën ti dhe më gjykon mua, po kur të më dëgjosh mua, ç'do të bësh? Hidh e prit?

Besniku — Jam gati të dëgjoj. Këtu ose dalim ja-shtë po deshe.

Astriti — Nuk është nevoja.

Besniku — Astrit, Eda për ty...

Astriti — Eda për mua ka qenë një shoqe e ngshtë, kurse unë për të kam qenë një i po-shtër.

Besniku — Kush e tha këtë?

Fatosi — Ore, vërtet, edhe mua më ka rënë në sy që...

Astriti — Të ka rënë në sy se unë nuk rri më në bankë me të? Rri, o Fatos e shkruaj vjer-sha, atë bëj, po, kur të marrësh vesh ti të vërtetën, ajo do të jetë në universitet, bile në ç'degë të ketë qejf. Kurse ti (*Besnikut*) ose unë, s'dihet se në ç'fshat e kemi ngri-tur folenë.

Fatosi — Unë di se ti do të vazhdosh universite-tin!

Astriti — Kur them unë rrush, të tjerët kanë ngrënë një kosh.

Agimi — Unë nuk po kuptoj asgjë.

Astriti — Kaq për shokët që shfaqën shqetësim për xhamin e thyer. Më vonë mund të dë-gjojmë rrëth saj edhe gjëra të tjera. U bëtë kureshtarë, pak sa për të shuar ku-

reshtjen: Jo shumë larg, po ndoshta pas një muaji, kur të fillojnë provimet e maturës, ajo do të vijë dhe do të ikë e shoqëruar nga i dashuri i saj.

Besniku — Kjo s'të prish punë ty; të paktën, kaq di unë.

Astriti — S'më prish punë. Nuk ditke pak, por ditke shumë. Veçse duhet të dish edhe këtë: kur unë i them tjetrit shok, i them me kokë, me zemër, qoftë ai ose ajo. I tillë jam unë. Ç'e mban miqësinë më të pastër se singeriteti?

Besniku — I paska munguar singeriteti Edës?

Fatosi — Aq sa mund t'i mungojë oksigjeni ajrit që thithim.

Astriti — Ruhu, shpirt romantik, se të tjerët ta hedhin kur të duash.

Besniku — Po më çudit.

Astriti — Nuk dua ta filloj nga e para, këtu nuk është sallë gjyqi, por është dhomë gjumi dhe unë dua të fle. (*Të tjerët dalin, mbetet Landi me Astritin shtrirë në krevat.*) Do të të pyes dhe m'u përgjigj, lajka mos më bëj, se as të bëj. Ti Valterin s'e ke kushëri dhe mua s'mund të më thuash që e kam.

Roland — Po, nuk e kam, veçse nga shoqëria me të nuk humbas asgjë. Nuk dua të kthehem më në rrëthim tim. Ti e di që unë banoj në fermë. Me këto nota që kam unë, atje kazma më pret, kazma e lopata. Ndërsa këtu, në këtë qytet të madh, mund ta gjej një punë më të mirë.

Astriti — Ti mendon se Valteri...

Roland — Valteri e ka babanë në komitet dhe...

Astriti — ...Dhe mund të përfitosh diçka, po, ama, duhen kushte dhe ti...

Roland — Sïkur i the Fatosit «Ruhu, shpirt romantik, se të tjerët ta hedhin kur të duash».

A s'flasim për kushte e, fare pa pritur e pa kujtuar, dikush e fitoi atë që desh.

Astriti — Veçse kjo ndodh rrallë.

Roland — E pse të mos jem unë ky rast i rrallë?

S'më eci këta katër vjet, po s'është e thënë që të mos më ecë më tutje. Unë gëzohem për ty, gëzohem si për veten time dhe dua që patjetër të vesh në universitet, kurse ti...

Astriti — (E ndërpret.) Pse mendon se unë ty nuk dua të të shoh mirë e më mirë, kaq keq menduake për mua?!

Roland — Ty nuk të barazoj me të tjerët, Astriti, jo, kurrë, prandaj, sa herë takohemi me Valterin, më shumë i flas për ty, për të ardhmen tënde sesa për veten time.

Astriti — Kjo edhe më çudit!

Roland — Si? S'ke besim se unë e bëj këtë?!

Astriti — S'e pata fjalën për ty, po për Valterin.

C'e shtyn atë që të më ndihmojë mua?

Roland — Shoqërinë që kam unë me të mos e nënveftëso, por ai ka edhe një hall tjetër... Ai nuk do që Eda të shkojë në shkollë të lartë... Atë e zë frika nga kjo. Dashuria e nisur do të tretet, pastaj do të shkrihet. Po shkoi Eda në univeristet, i thotë atij «ku të kam parë». Ai me shkollë të mesme ësh-

të e, dhe për këtë, nuk jam i sigurt në e ka mbaruar të tërë apo jo.

Astriti — Po Eda... mund të shkojë në degë tjetër, po s'i doli për filozofi.

Rolandi — Kush tha?

Astriti — Vetë ajo, a s'dëgjove atë ditë?

Rolandi — Të mendoja unë kaq cekët, askush nuk do të çuditej. Po jo ti, jo ti, Astrit. Mbrëmë, kur mbaroi grindja me atë kamerieren, me të ikur ti, u gjend i ati i Valterit. E shyqyr që erdhi, se s'dihej si do të mbaronte ajo punë! Pra, me të qetësuar gjendjen, i ati i Valterit u takua edhe me një burrë tjetër që, të betohem, tip më servil s'më kishin parë sytë. A ta merr mendja se cili ishte? Ke të drejtë të mbledhësh supet. Ishte i ati i Edës. E, siç më tha Valteri, edhe në shtëpi kushedi sa herë i ka vajtur. Dhe jo ashtu, me duar në xhep...

Astriti — Pra, qenkan hedhur në sulm si familje!

Rolandi — Si të qeshet.

Astriti — Nuk më qeshet, Roland, përkundrazi, më vjen të përqesh veten, ta tall... Në atë familje e kam ndier veten si në shtëpinë time. Njerëz më të mirë e më të sinqertë s'ke ku i gjen. Po ja ç'po shoh.

Rolandi — Të ka thënë, jemi në fund... U bë ç'u bë për këta vjet, harrohet; ti ke qenë më i miri, më i sjellshmi për Edën. Në shtëpinë e saj, më tepër se ti kush ka vajtur nga ne. Vec, ama, deri tani; sot e tutje — stop. (*Lo-jë*) Eda s'ka pasur nevojë për ndihmën

tënde. Ajo e ka marrë notën shkëlqyeshëm vetë. Pse të kemi pranuar ty në shtëpi? Në ka ardhur keq... Djalë nga fshati... konvikt... Gjynah... Nuk sheh zjarr me sy pér 4 vjet... A jo, sot e tutje jo. Vajza na u rrit... a s'e sheh, po na e kërkojnë edhe djemtë e shokëve të komitetit. Na vjen keq, po...

Astriti — S'kam nevojë pér mëshirë unë, Roland. Mjaft!

Rolandi — Shfaqa vetëm arsyetimin e tyre... e ti bën shumë mirë që e shkelmon. (*Hyn Valteri.*)

Valteri — Mirëmbrëma, dituri e mbyllur në kullë. Mezi më la ai plakü i tmerrshëm që keni rojë. Jam kushëri i Rolandit, i thashë. Si shumë shpesh po vjen, ma ktheu ai. Më dërgoi babai, ia ngjesha unë e, kur e mori vesh se i kujt isha, më la. S'qenkeni në formë sot më duket. Hajdeni, se pas pak do të shkojmë në një ambient ku ka alegri, muzikë. Ah, kam një surprizë pér ty. Astrit. Bisedova me babanë pér punën tën-de. Të ketë mesataren më tha, se e rregulloj unë.

Rolandi — Pse të dëgjon kaq shumë babai ty, Valter?

Valteri — Po një djalë ka ai.

Rolandi — Prandaj edhe të përkëdhel. Pa punë je dhe xhepat i ke plot.

Valteri — Kam qenë në 2-3 vende pune, po s'më kanë pëlqyer. (*Nxjerr paketën.*) Ndize, Astrit, ky në çaste të vështira ia kalon edhe

shokut më të ngushtë, për shembull ia kallon edhe Roländit, që s'të lë gjë pa të treguar. Astrit, e shoh që po më vëren me syrin e xhelozit, por dëgjo: falja Edës, kështu veprojnë këto vajzat e shkollës së mesme. Zënë shoqëri me ndonjë djalë të klases së tyre, po për të dashur nuk mund ta duan, për të dashur duan atë tjetrin që e njeh jetën... Atë tjetrin që ecën në anën tjetër të trotuarit.

Roland — Domethënë, ne na mbajnë si çadër...

Astriti — Unë s'i kam shërbyer askujt si çadër,
Roland.

Roland — Ti, a nuk i the Edës?

Valteri — Çfarë i tha Edës?

Roland — I tha se më ke mbajtur thjesht si çadër.

Astriti — Mjaft, Roland.

Valteri — E madhe kjo!... Ky është vërtet një mendim i madh, një gjetje e madhe (*Imiton.*) Më ke mbajtur thjesht si çadër... S'ke ç'bën, vëlla, duhen luajtur në jetë të gjitha rolet.

Astriti — Unë e kam pasur...

Valteri — Nuk më intereson çfarë e ke pasur ti, po ç'të ka pasur ajo ty; kjo më duhet mua. Fol, Roland (*Provokon.*), se më ke thënë përtë që është vajzë e ndershme.

Roland — E ndershme është.

Valteri — Vec pasi ka provuar dashurinë e parë.

Astriti — Myllë gojën. Thashë se e kam pasur shoqe, kam miqësi...

Valteri — (*Vazhdon të tijën.*) Hë, ç'fjalë, mi-që-si...

të duket sikur ha sheqer... midis një djali
dhe një vajze paska miqësi!... Vetëm mi-
qësi, s'po kuptoj.

Astriti — Kurrë mos e kuptofsh.

Valteri — (Qesh.) Ti je një djalë i mrekullueshëm,
Astrit, dhe tepër i sinqertë.

Rolandi — Shyqyr!

Valteri — Si?

Rolandi — Që kur ke ardhur dhe deri tani, e
vetmja fjalë e mençme që the.

Valteri — Cila?

Rolandi — Ato çka the për Astritin.

Valteri — Ato, ë, ato; ku e lashë?

Rolandi — Te cigarja. (*Merr buzagaz një cigare.*)

Valteri — Ndize edhe ti, Astrit... Ndize... si të
duash. Sot më pëlqeve më tepër se çdo he-
rë tjetër. Një fije dëshimi e xhelozie e ki-
sha ndaj teje, merre si të duash. Ja ku po
të jap fjalën se, c'kam premtuar për ty,
do ta bëj: ti do të shkosh në atë degë që
do e kjo nuk diskutohet. Besoj s'është pak.

Rolandi — Po për mua?

Valteri — Ti, Landi, duhet të kalosh një herë në
lëndën e letërsisë. Pastaj, kylmi, të mbetesh
në letërsi! Po pse, nuk di vjersha ti; këputja,
ore:

Bie shiu pikë-pikë,
o moj nënë, sa kam frikë.

Rolandi — Tallu ti, tallu! Nuk merret vesh ai më-
suesi i letërsisë ku jë vë katër, ku të vë
dhjetë.

Valteri — Këta që merren me letërsi, ashtu janë,

fluturojnë. E, pra, ruaje, kur të jetë në fluturim e sipër, këputi një pesë aty prapa katrës dhe e pat.

Rolandi — Si, si?

Valteri — Ka variante sa të duash. Kur kam qenë unë në shkollë, sajoja njëqind forma për t'ua hedhur profesorëve.

Rolandi — Një dua unë.

Valteri — Kam merakun e atyre shtatave të Astritit. Të lë në baltë shtata, të bëhet bisht. Të vjen plasje. Ja sikur ka ardhur shtatori, të tjerët shkojnë në universitet në Tiranë! Ah, Tiranë. Në Tiranë ështëjeta, o vëlla. Qytet i bukur, i madh e jo si ky yni, me një bulevard! Qytet që s'guxon t'i flasësh një vajze, se në darkë, me siguri, i ka vajtur lajmi plakut në shtëpi... Më besoni, djema, pale sikur të jesh në Tiranë e të jesh student... Kjo është vërtet mrekulli... Ah, ç'fat! Unë s'pata kokë! Ti, Astrit, do ta shijosh këtë... Të betohem.

Rolandi — Ç'do të bëhet me mua, Valter? A ke biseduar gjë?

Valteri — Të paktën të kalosh, Roland, se kot që fjalosemi e mundohemi... Djallosu pranë njerkës pastaj...

Rolandi — Kurrë! Ku dreqin mësuesi vajti e më vuri atë katrën! E kur, tani që kanë nisur të nxjerrin edhe përfundimet! (Valterit) Ç'më qesh?

Valteri — E shoh, do ndonjë nga ato variantet e mia ti... ë, e gjeta...

Rolandi — Si? Çfarë?

Valteri — Në sallën e mësuesve janë regjistrat, e atje...

Rolandi — Regjistrat... çfarë, unë?!

Valteri — Ngadalë, se po të bie të fikët. S'e kam fjalën për ty, për ty edhe muret kanë sy, ti je nxënës i dobët e bie në sy. Dikush tjetër duhet ta bëjë.

Rolandi — Shoqëri e shkollës së mesme, shoqëri kleçkash...

Astriti — Ç'do të thuash?!

Valteri — (*Lojë me Rolandin*) Dua të them se mbrëmë pas atij skandalit te pastiçeria që ti ia mbathe, përpara doli Rolandi si autor. Dhe emri i tij u dëgjua edhe në zyrat e policisë. Qetësohu, Landi, im atë po mundohet ta zbutë çështjen, veç, ama, s'e ka të lehtë, askush nuk të mbron kur qëllon dikë e sidomos një femër.

Astriti — Pse, e qëlloi ndonjëri kamerieren? Për të fyer po, por...

Valteri — Ti s'mban mend asgjë. Ty një gotë konjak të turbulloj fare... Sot në mëngjes dy vëllezërit e kamerieres më kapën mua e kërkonin të dinin se cili ishte ai që u kishë goditur motrën. Dhe unë gati...

Rolandi — Valter, ai jam unë; more vesh, jam unë! Ata vëllezërit e saj e kushdo tjetër, ja ku më kanë mua, le të më bëjnë ç'të duan; emri i Astritit nuk duhet të dalë askund. E kupton, Valter, çdo masë ndaj tij i diskuton të ardhmen, dëshirën që ka ai, kurse mua, me mua...

Valteri — E shoh, e shoh, Roland. Ti nuk e shit-
ke lehtë shokun.

Astriti — As unë nuk i shes ata.

Valteri — Llafe.

Astriti — Ti nuk më njeh.

Valteri — Vepro, pra... Shoku po të mbetet në
klasë... Kaq gjë s'mund të bësh pér të?...
Ne po i angazhojmë të gjitha forcat. (*Ndër-
kohë hyn Agimi, të cilin e shqetëson tymi
i duhanit.*)

Rolandi — Mos erdhe ta ndezësh një herë?

Agimi — Erdha të marr kitarën e Besnikut, këtu
qenka bërë klub. Po pini duhan?

Valteri — Burrat cigare pinë, nuk lëpijnë akullore.

Agimi — Nuk fola me ju.

Valteri — Edhe këta burra janë.

Agimi — Astrit, Roland!

Valteri — Do ta dërgoj Rolandin të blejë një ka-
llam apo do ta ndezësh një herë.

Agimi — As ti s'duhet të pish cigare.

Valteri — Ku është tabela?

Agimi — Çfarë tabele?

Valteri — «Ndalohet duhani.»

Agimi — Këtu është konvikt e tabela është kudo.

Valteri — S'po shoh gjë.

Rolandi — Është shkruar anglisht e ti, Valter...

Agimi — Pse, di ky anglisht? Pa ta provoj një-
herë? (*Bën imitim e shqiptimit të saj*)

Rolandi — Valter, ky është...

Agimi — Unë jam, mos kujton se ia kam frikën?

Valteri — Ke ardhur të mësosh në shkollë apo të
mësosh boksin?

- Agimi — Për të dyja, si të jetë nevoja.
Valteri — Dëgjo ti, djalosh qumësh tak!
Agimi — Po të dëgjoj, o kokorosh.
Valteri — Shiko, se të bëj...
Agimi — Provoje. (*Ndërkohë hyjnë Besniku dhe Fatosi.*)
Valteri — (*I frikësuar*) Hë, çuna, do të ikim?
Rolandi — Vish golfin, Astrit. (*Astriti bën ta veshë, por ia rrëmbejn Besniku.*)
Besniku — Roland, thirri mendjes, shokët kanë filluar nga pyetjet.
Rolandi — Mirupafshim, o konviktorë të përjetshëm. (*Del.*)
Agimi — (*Turret.*) Ky do dru, unë betohem se ky do dru.
Astriti — Të tjerët nuk hanë bar, trimëri mos na shit.
Besniku — Si shumë po të pëlqejnë këto ambientet jashtë shkollës, Astrit.
Astriti — Mos janë ambiente të huaja.
Besniku — Kur nuk çmohet ky ambient që na rriti për katër vjet rresht, vlerat e atyre ku bredh ti nuk peshojnë gjë. Ki kujdes se...
Astriti — Mos vallë do të më përmendësh edhe mua provimet.
Rolandi — (*Thërret nga jashtë.*) Astrit, Astrit.
Besniku — Ulu e rri aty.
Astriti — Do të dal, nuk mund të rri.
Besniku — Dhe me kë do të dalësh, me atë që deri para ca kohe e quaje tyryfyl, bredharak etj?
Astriti — Me ç'të drejtë më flet kështu?

Besniku — Me të drejtën e shokut. (*Dëgjohet zëri i Rolandit.*)

Roland — Astrit!

Astriti — Thashë do të dal... (*Niset.*)

Agimi — Shko se të presin pasqyrat.

Astriti — Jo, më pret ajo trikoja e leshit që mban ti. (Del.)

Agimi — (Pauzë) Mos më mblidhni supet, se ja ku po jua them që këtij njeriu i kanë dalë mendtë mbi flokë. Mos vallë ka bërë ndonjë budallallék?

Fatosi — Çfarë të ketë bërë?

Agimi — Po ja, kudo të shkon mendja, kudo. Të shkon edhe pér keq. Ky me Edën se ç'ka! Mos vallë i ka propozuar... Pse qesh?

Fatosi — Qesh, qesh se ti ashtu flet.

Besniku — Mos fol pér gjëra të paqena, Agim. Nekëtu jemi shokë e para kësaj ndjenje nuk vëmë ašgjë tjetër.

Fatosi — Jam me ty, Besnik. Edhe në qoftë se do të bëhem ndonjë ditë poet i vërtetë, këtyre viteve do t'u kushtoj këngët më të bukur. Vite të pastra. Vite të qarta si ky qiell, si këto yje. A e dëgjoni këngën e tyre? (*Besniku i bie kitarës dhe këndon.*) Ja, kjo është kënga e gjuar, si të gjitha këngët e rinisë sime:

*O vite të rinisë,
e bukura, e dlira, miqësi,
këshfu do të jetoni në kujtesë
edhe kur të na trokasë e bardha pleqëri.*

Pamja e tretë

Veprimi në klasë, gjendja dramatike, hyn Lumi.

Lumi — Vajza, e kemi bosh, profesor Bardhi mungon.

Mira — Profesori këtu është, por erdhe ti me vonesë.

Lumi — Ku është? (*Mira i thotë diçka në vesh, Lumi lëshon klithmë.*) Uaaaaaa, në regjistër, në regjistër?! Unë do dal jashtë, nuk mundem.

Eda — Ulu, ulu e rri si të tjerët.

Lumi — Të lutem, Eda, unë nuk duroj dot.

Eda — E shoh që je zverdhur.

Fatosi — Kështu bën gjithmonë kjo: pak dhe, tragjedi!

Lumi — Uaaaaaa! Drita po qan, për kokë të masë, po qan.

Agimi — E mbushe klasën plot me «ua», ç'dreqin ke?

Lumi — Nuk flas, nuk flas, keni për të parë po e hapa gojnë.

(*Hyn Bardhi dhe byroja e rinisë.*)

Vjollca — Qetësi, ngreje kokën ti, Drita. S'je mirë?
Lumi — Edhe unë nuک jam mirë. Mund të dal ja-shtë?

Agimi — Ulu, moj llasticë, ulu.

Vjollca — Mendum të mos e shtyjmë këtë mble-dhje rrufe të organizatës dhe kështu do të bëjmë. Jemi përpara një ngjarjeje të jashtë-zakonshme, shokë, por, duke e ndihmuar njëri-tjetrin, do t'ia dalim mbanë.

Lumi — Pse, eshtë e vërtetë se Astriti ka hyrë në sallën e mësuesve?

Rolandi — Astriti? Ç'do Astriti në sallën e mësuesve?! Askush nga ne s'ka punë atje.

Agimi — Atje janë regjistrat.

Astriti — Ç'do të thuash ti, Agim?!

Agimi — Dua të them se...

Vjollca — Lëre, Agim, ne këtë kërkojmë, ta dëgjojmë prej teje, Astrit.

Rolandi — Astriti eshtë nxënës i përgatitur dhe...

Agimi — Dhjetat të gjithëve na pëlqejnë, shokë, po kur kërkojmë t'i marrim ato pa i merituar, atëherë s'është më ndërgjegja jonë. por e një mikroborgjezi. (Reagime).

Astriti — Atë fjalë mbaje për vete.

Vjollca — Astrit, mos u ngut, dëgjoje shokun, dë-gjoi të gjithë me radhë.

Astriti — Siç do të më dëgjojnë edhe ata mua, apo bëj përjashtim unë, shoqja sekretare.

Bardhi — Ajo s'tha se bën përjashtim. Do të dëgjojmë njëri-tjetrin, se prandaj jemi mble-dhur: jemi shokë të një klase.

Vjollca — (Astritit) Do të flasësh ti?

Astriti — Do të flas që ç'ke me të (*Ngrihet.*)

Vjollca — Urdhëro e fol.

Astriti — Do të dëgjoj një herë. (*Ulet.*)

Vjollca — Megjithatë, Agimi ka të drejtë.

Astriti — Epitetin që tha le t'ia varë dikujt tjeter.

Vjollca — Kujt??

Astriti — Ndonjë nxënësi të dobët.

Vjollca — Megjithatë, unë e përsëris se nga një ndjenjë e tillë askush nuk duhet ta quajë veten të paprekshëm.

Rolandi — Nxënësi i mirë po.

Vjollca — Roland, përse shkojmë ne në fshat, përtë ngritur një fole? Po në universitet përse shkojmë, përsëri përtë ngritur një folezë?

Rolandi — Përse më pyet mua, unë s'kam shprehur një mendim të tillë.

Vjollca — E ka shprehur një nxënës i mirë.

Rolandi — Nuk di gjë.

Vjollca — Mendim që ka dalë nga dhoma juaj.

Rolandi — Nuk di gjë, të thashë.

Astriti — Informata është e saktë. Me se i keni shpërblyer informatorët.

Bardhi — C'janë këto informata dhe informatorë?

Astriti — S'thashë për ju, shoku mësues.

Bardhi — Këta janë shokët e tu, Astrit.

Rolandi — Astriti, shokë, është një nga nxënësit më të mirë.

Mira — Mos na bëj karakteristikën e Astritit ti, po të jetë nevoja për karakteristikën e tij, ka kush e bën.

Rolandi — A më thatë të flas?

Vjollca — Po, por filloje nga koka.

Rolandi — Nga cila?

Vjollca — Nga shoqëria jote me të. Fol për këtë një herë, pastaj na trego se ç'e shtyu Astritin të hyjë në sallë. Mos mblidh supet. Pavarësisht se veprimi s'është bërë, ne luftojmë mendimin që e shtyu atë.

Lumi — Uaa, po sikur Astriti... hë, more Astrit, fol ti; të ketë hyrë kot në sallë?

Besniku — Si kot?

Lumi — Kot, fare kot.

Besniku — Për të pirë ujë.

Lumi — Uaa!

Agimi — Filluan uatë!

Eda — T'i hapim zemrën njëri-tjetrit, më mirë se kështu nuk ka.

Vjollca — Drita, po na shqetëson shumë, çfarë kë?

Rolandi — Ç'të mos ketë.

Vjollca — Ç'do të thuash?

Rolandi — Dua të them se ka njerëz që i kanë kthyer mbledhjet në pasion.

Vjollca — Cilët janë?

Astriti — Ahu!

Vjollca — Ju të dy ka kohë që jeni kthyer në binomë. Ndaj nuk çuditem se pyetjes që i drejtova atij iu përgjigje ti. Cilët, pra, na i paskan kthyer mbledhjet në pasion?

Astriti — Nganjëherë ty të thuhet prej shokëve ndonjë shprehje e tillë ndoshta edhe me shaka, se ti po e merr shkollën si me korrespondencë. Shakaja nuk është larg së vërtetës...

Vjollca — Mbledhjet ku vete unë janë për çështje
pune e jo për teka. Unë nuk i kam lënë
pas dore detyrat e mia si nxënëse.

Astriti — Vazhdo, vazhdo.

Vjollca — Vazhdo ti, ti e ke radhën.

Astriti — Unë s'kam ç'të flas.

Drita — (*E revoltuar*) Do të flas unë! Nuk duroj
dot. Ne të pamë në sallë, Astrit, dhe me re-
gjistër të hapur.

Lumi — Uaaaaa!

Agimi — Mjaft më me uaa, na mërzite.

Astriti — (*Dritës*) Nuk jام unë ai që ka kënduar
për sytë e tu, jo.

Fatosi — Jam unë, q'do të thuash? Unë u kam
kënduar e do t'u këndojo shoqeve të mia.

Bardhi — Astrit! Të dëgjova me vëmendje e po
më vjen keq, po më vjen hidhur. Rri, rri,
shoh që edhe goja të është prishur. Të ka
pasur bukuri fjala, por... nejse... Ngrehu së
paku e kërkoi të falur Dritës dhe pastaj na u
drejto neve.

Astriti — Çfarë doni prej meje?

Besniku — Çiltërsi.

Astriti — Le ta tërheqë Drita atë çka tha. Të mos
flasë kot. Po të ketë inat me mua, le ta
nxjerrë herë tjetër.

Drita — Çfarë inati kam unë me ty, Astrit? S'mbaj
mend të jemi grindur ndonjëherë. Unë tha-
shë atë që pashë. Më vjen inat tani për dikë
tjetër që rri e s'flet.

(*Ulet, heshtje e rëndë, ngrihet Eda.*)

Eda — Do të flisja, Drita, do të flisja. U nxitove
pak.

- Rolandi — Ulu, Eda, ti fole një herë.
- Eda — Do të flas përsëri. Të thashë, u nxitove, Drita. Por prisja që Astriti të fliste vetë. Ne jemi shokë. Jemi një kolektiv dhe miqësia midis meje dhe Astritit ka qenë si të thuash, një nga majat e tij. Flas dhe më duket se diçka e shtrenjtë më ikën nga veta. Nuk qenka e lehtë, po e vërteta duhet thënë. Çohu, Astrit, për hir të miqësisë bëje këtë, se edhe e mira kjo është.
- Astriti — Cila na qenka e mira?
- Eda — Nuk mund të dyshoj se ti vërtet nuk e kupton cila është e mira jote dhe jona.
- Astriti — Unë nuk jam këtu për t'i bërë qejfin njërit apo tjetrit.
- Vjollca — Ne jemi shokët e tu e presim të dëgjojmë fjalën tënde.
- Astriti — Nuk kam ç'të them.
- Eda — Astrit, të vura re, qysh në mëngjes më ra në sy shqetësimi yt. Fola edhe me Dritën. Ne të dyja u gjendëm pranë.
- Astriti — Po na bën skenar filmi tani.
- Eda — Nuk bëj skenar, Astrit, jo. Natyrisht, unë nuk mendova se ti do të shkoje deri te regjistri, por i thashë Dritës se doja të të takoja.
- Drita — Po, kështu, kështu është, Astrit, «dua ta takoj», më tha, «se ashtu kam edhe një porosi», kur ja, fare pa pritur ne të pamë në sallë.
- Astriti — Unë vërtet isha në sallë, por...
- Lumi — Ishe në sallë?

Besniku — S'po marrim vesh, një herë thua kësh-tu, një herë ashtu. Ishe apo jo?

Astriti — Po ti pse ngulmon kaq shumë? Ç'kërkon të zbulosh?

Agimi — Atë që fsheh ti.

Astriti — Dhe që paske marrë përsipër ta zbulosh ti! E pra, jepi, jepi, Sharlok Holms.

Bardhi — Mjaft. Ç'janë këto fjalë, Astrit? Po, po, krejt ndryshe, pale, shoh që edhe në të folur jeni prishur. Ç'ka ndodhur me të. Shokët po të flasin me zemër të hapur.

Astriti — Se mos janë më të mira të këtyre të tjerëve.

Bardhi — Çfarë?...

Astriti — (Heshjtje) Po, isha në sallë.

Lumi — Qyqja! Ua! Ishe në sallë?

Astriti — Jo, nuk isha. Nuk isha e qaj tani, qaj.

Lumi — Po ti ç'ke me mua (Tjetrit), po ti, po ti?

Besniku — Ishe apo nuk ishe?

Astriti — Nuk isha, nuk isha, ç'keni me mua? Të gjithë më jeni qepur, që të gjithë. (Ulet i trembur, gjendje e nderë.)

Besniku — Astrit, kisha mendimin se...

Astriti — Mjaft. Të njoha, të njoha edhe ty se cilë je.

Vjollca — Qetësohu, Astrit... Mos vallë do që të bëjmë një pushim?

Astriti — Pyet ato të dyja, ato që më paskan parë në sallën e mësuesve.

Eda — Ta zëmë se nuk të pamë.

Astriti — Thuaju, thuaju këtyre se nuk më keni parë.

Mira — Eda!

Eda — Tani një pyetje do të bëj dhe m'u përgjigj drejt, bëje edhe ti këtë pér hatër të shoqërisë: e kujt është kjo fletore?

Astriti — Ku e di unë!

Eda — Të thashë, në emër të shoqërisë m'u përgjigj; përgjigju, se e ke më të lehtë se unë.

Astriti — Pse?

Eda — Se do të thuash të vërtetën, kurse unë do të gënjej. Këtë fletore ti e harrove atje mbi tavolinë.

Astriti — (*Gjendje e nderë. Ai sheh nga Rolandi.*)
Unë hyra në sallë, po jo pér qëllimin tim,
pér hallin tim... po... pér Rolandin.

Rolandi — (*I befasuar*) Pér mua!!! Çne, ti të hysh
në sallën e mësuesve pér mua? Ç'më nga-
tërron mua. Ah, të lutem shumë, këtu, ve-
tëm këtu mos e kërko ndihmën time... Nuk
të ndihmoj dot.

Astriti — Ashtu!!!

Rolandi — S'kam ç'të bëj.

Astriti — Mirë, Të lumtë!... Unë, shokë, nuk kam
qenë kund, as në sallë dhe askund. Nuk
kam pér të thënë më asgjë.

Agimi — Kjo është kokëfortësi, kokëfortësi dhe
mungesë singjeriteti.

Vjollca — Ka shok tjetër pér të folur?

Agimi — Të gjithë shokët e dhanë mendimin e
tyre.

Vjollca — Diskutimet, siç u vu re, ishin thirrje
ndaj teje, Astrit. Po e përsëris, ke gjë pér
të thënë? Ka kush ndonjë propozim? Meqe-

nëse kam fjalën, po jap mendimin tim. Propozoj për Astritin një vërejtje përpara organizatës.

Besniku — Kush është dakord?... Kundra ka?

Vjollca — Për masën do të njoftojmë edhe komitetin e rinisë.

Eda — Astrit!

Vjollca — Mbaruam. (*Pas një heshtjeje dalin. Mbeten vetëm. Astriti, i cili ka ulur kokën, dhe Eda më tutje.*)

Eda — Astrit!

Astriti — Ti këtu!

Eda — Astrit!

Astriti — Fitove!

Eda — Çfarë fitova?

Astriti — Pse, pak të duket të fitosh të drejtën?

Eda — Të drejtën e studimit? Unë këtë do ta fitoj si të gjithë shokët e shoqet e mia.

Astriti — Për filozofi nuk shkojnë dhjetë.

Eda — Mund të shkojë edhe një.

Astriti — Kjo një je ti.

Eda — Mund të jesh edhe ti.

Astriti — Prej meje shpëtovë. Mua s'më ke më...

Eda — S'të kam konkurrent! Ende këtë fiksim mban në kokë ti, Astrit. Qetësahu dhe për hir të shoqërisë mos më hidh baltë. Ta kërkoj këtë si shoqe, si vajzë. Kurre s'ka dalë prej meje gjë e keqe për ty.

Astriti — Sa e pastër është fjala.

Eda — Edhe vepra e tillë është.

Astriti — Cila vepër? Qëndrimi që mbajte apo letra?

Eda — S'të ka mbetur gjë tjetër veçse të kapesha pas letrës së një rrugaç; po deshe ti, dalim jashtë dhe një pështymë jam gati t'ia hedh atij surrat. Qetësohu, Astrit, dhe pranoj se ajo letër s'qe gjë tjetër veçse një batak ku ti u mbështete për të përligjur mendimin e keq që ti kishe filluar të ngrije përmua.

Astriti — Po si, si ka mundësi që u gjend ajo letër në librin tënd?

Eda — Prisja ndihmën për ta zbuluar edhe këtë. Nuk dyshoj te ti, mund të dyshoj te dhjetë, njëzet, po kurrë te ti. Po, në fund të fundit, ç'rëndësi ka ajo paçavure. Një tjetër gjë më shqetëson. Pse ti i besove aq shumë asaj? Do të përgjigjem unë edhe përkëtë? Dëgjo, pra. Ti asaj dëshirës sate përtë vazhduar në atë degë që e lakmon me aq pasion, i ke ngritur kult, i paske ngritur kështjellë dhe na sheh ne të tjerët me sytë e një ambiciozi, rivali... Për hir të plotësimi të kësaj dëshire, je gati të na vësh edhe shkelmin.

Astriti — Eda!

Eda — Ç'të shtyu të hyje në sallën e mësuesve? Pse s'përgjigjesh? Pse s'iuh përgjigje shokëve? Edhe nëse s'hyre për interesin tënd, po për atë të Rolandit tënd të famshëm, gabimi është i njëjtë. Ç'kusht të vuri ai që t'i të bëje atë «sakrificë»? Pastaj pse ngjiti kaq fort kushti në ndërgjegjen dhe në mendjen tënde? Ja, pra, këto të kishe zbërthy-

er përpara shokëve... Pse më rri kështu?...
Më pyesin prindërit për ty e s'di ç'tu them.
Astriti — U thuaj, u thuaj se qe një fëmijë dhe
asgjë më shumë.
Eda — Unë nuk mund t'i gënjej ata.
Astriti — U thuaj, pra, se qe një i poshtër.
Eda — Të thashë, nuk mund t'i gënjej. Mbrëmë
kishim ditëlindjen e babait. Ti nuk erdhe.
Por mos harro se ke qenë i pranishëm për
katër vjet rresht.
Astriti — Eda, Eda!
Eda — (*Nxjerr nga çanta diçka dhe ia lë mbi tavolinë.*) Meqenëse nuk erdhe, mamaja s'të
ndan nga ne të tjerët. (*Del.*)
Astriti — (*Pauzë*) Eda!... Mos e prisha keqas këtë
punë?!

Paraskenë e tablosë së katërt

(*Eda duke ecur, hyn papritur Valteri.*)

Valteri — Eda! (*Eda stepet një çast.*) Të lutem vetëm një çast, një minutë...

Eda — Qenke i çuditshëm. Të kam thënë edhe një herë tjetër. Prandaj... (*Bën të largo-het.*)

Valteri — Ti kërkon të bindesh se unë e kam seriozisht.

Eda — Mos u bëj qesharak. A nuk e sheh se ato shoqet atje po shkrihen së qeshuri? Largohu...

Valteri — Eda... Kam parë një natë së bashku të dy prindërit tanë... A e di sa u gëzova! Po të duash, u kérkojmë ndihmë atyre dhe...

Eda — Të gënjen mendja, mor i shkretë! Mos kë ndër mend t'i futësh edhe tim eti ndonjë letër?... Futi, futi, se kjo ka për të bërë efekt tamam.

Valteri — Mjafton që të bindesh ti, po jam gati të bëj ç'të duash... veç fol, fol.

Eda — Mos më bjer më në qafë, këtë dua prej teje.

Valteri — Më jep fjalën, pra... Apo ende vazhdon të kesh mendjen tek ai... Largohu prej Astritit, a më dëgjon, Eda. 'A e pe se ç'tip është?... E sheh që doli fjala ime? Puna e tij ka vajtur deri në polici!...

Eda — (*Qesh me qesëndi.*)

Valteri — Mos qesh, e kam me gjithë mend. Ka rrahir një kameriere. Të duket e pabesueshme? Rrezik ta 'kenë thirrur në rajon që sot...

Eda — Astriti të bëjë skandal?!

Valteri — Uluni, uluni këtu dhe dëgjomë më tutje... (*Ai bën të ulet, ajo përfiton e largo het.*) Iku, u tërbua, e luajta mendsh. Edhe nja tri-katër sulme të tilla do ajo dhe e pat. E pastaj ku do të vejë?

Te ti vjen flladi i dashurisë
e zemrën ledhaton.

Oh, ti, djalosh i dashur,
puthmë, përqafomë.

(*Vajzat atje matanë qeshin me zë dhe ai largohet i befasuar.*)

3. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që

5. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
8. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
11. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
14. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
17. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
20. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
23. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
26. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
29. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
32. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
35. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
38. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
41. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
44. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
47. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
50. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
53. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
56. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
59. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
62. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
65. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
68. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
71. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
74. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
77. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
80. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
83. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
86. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
89. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
92. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
95. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
98. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
101. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
104. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
107. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
110. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
113. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
116. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
119. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
122. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
125. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
128. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
131. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
134. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
137. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
140. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
143. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
146. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
149. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
152. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
155. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
158. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
161. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
164. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
167. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
170. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
173. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
176. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
179. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
182. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
185. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
188. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
191. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
194. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
197. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
200. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
203. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
206. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
209. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
212. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
215. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
218. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
221. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
224. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
227. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
230. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
233. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
236. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
239. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
242. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
245. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
248. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
251. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
254. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
257. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
260. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
263. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
266. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
269. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
272. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
275. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
278. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
281. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
284. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
287. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
290. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
293. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
296. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
299. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
302. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
305. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
308. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
311. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
314. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
317. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
320. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
323. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
326. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
329. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
332. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
335. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
338. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
341. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
344. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
347. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
350. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
353. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
356. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
359. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
362. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
365. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
368. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
371. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
374. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
377. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
380. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
383. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
386. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
389. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
392. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
395. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
398. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
401. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
404. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
407. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
410. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
413. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
416. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
419. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
422. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
425. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
428. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
431. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
434. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
437. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
440. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
443. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
446. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
449. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
452. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
455. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
458. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
461. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
464. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
467. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
470. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
473. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
476. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
479. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
482. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
485. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
488. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
491. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
494. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
497. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që
500. Bëzhëtë sëmjoshtë e përdorur, që

Pamja e katërt

Astriti është duke studiuar. Hyn Fatosi duke kënduar lehtë dhe afrohet pranë tij.

Fatosi — I tmerrshëm je. Paske filluar nga pyetjet e provimeve. Do të studioj me ty këtë periudhë, nuk të ndahem... Apo ke ndën mend të studiosh edhe tani me Edën?

Astriti — Unë, unë me Edën! U bë gati një javë që edhe përpara syve më vjen zor t'i dal.

Fatosi — Budalla! Fal ajo, fal. Eda është zemërgjerë, zemërmirë, lum kush është shok e mik i zemrës së saj.

Astriti — Fatos!

Fatosi — Megjithatë, ajo është shumë zemërgjerë e shumë, shumë zemërmirë. (*Largo het me humor duke recituar.*)

Astriti — (Vetëm) Dhe ju të gjithë, vëlla, të gjithë të tillë jeni. (*Mbështetet diku i menduar, hyn Rolandi pak i frikësuar që e sheh Astritin në atë gjendje dhe, pa u vënë re, kërkon të largo het. Astriti përmendet.*) E, Roland!

Rolandı = (I hutuar) Hic...

Astriti — Hic. (Rolandi mbledh supet.) Fare, fare?

(*Rolandı bën tē dalë.*) Ulu, ulu aty se dua tē këmbej dy fjalë... U mbush gati dy javë prej asaj mbledhjes, ku unë mora çka meritova.

Apo jo? Kam pritur që ti tē më thuash diç-ka, se patjetër diçka ke pér tē më thënë. Nuk ke? Atéherë dëgjo, dëgjo se kam unë. Në qoftë se do tē jetosh qoftë edhe një ditë tē vetme, jeto si njeri e jo si mi, më dëgjon, jo si mi!

Rolandı — S'kisha si veproja ndryshe, Astrit. Ti e di hallin tim e s'mbaj dot tē tjerë. Po vjen fundi... ku do tē vete.

Astriti — Mjaft, mjaft me këto qaravitje

Rolandı — Po tē them hallin, nuk po tē qahem.

Astriti — Halli nuk përballohet duke i kthyer shpinën, duke u kërrusur.

Rolandı — Fjalë goje! Të them paç hallin tim, paç fatkeqësinë time, nuk ta them dot, nuk ma nxe goja.

Astriti — Nuk është e vërtetë, Roland, as njëra, as tjetra nuk qëndron, më kupton, as njëra, as tjetra.

Rolandı — Këtë e di unë, unë e kam hallin jo vëtëm këtu, (*I bie supeve.*), por edhe këtu, këtu. (*I bie gjoksit pranë zemrës. Pauzë. Hyn një djalë.*)

Djali — Roland, tē kërkon ai shoku yt, Valteri...

Rolandı — I thuaj tē hyjë, tē vijë...

Astriti — Jo... i thuaj tē qërrohet, s'ka punë më me ne.

Roland — Ka ardhur përmua e t...
Astriti — Roland, larg atij njeriu, larg. A se kupton?

Roland — (I bërtet djalit.) Të thashë, thuaji të vijë këtu, ç'pret?

Astriti — Atëherë po iki unë. (Del. *Roland ngetlet vetëm, në heshtje të plotë. Hyn Valteri dhe i hedh me teatralitet një golf Rolandit.*)

Valteri — Vishe, se rrobja e bukur edhe derrin e kthen në ashik. (Afrohet te *Roland dhe i pëshpërit emrin e Edës.*)

Të dua, i thashë, për tokë dhe për qiell, të betohem.

Dhe ja si ma ktheu:

Betimi prej zemre doli.

Burbuqja që sapo çeli.

pa vonesë e plotë do lulëzojë...

Së shpejti, Roland. së shpejti, a spo më përqafon?

Roland — A bisedove me babanë për hallin tim?

Valteri — Përqafomë, mos m'i thaj krahët, megjithëse në këtë boshllëk, vec trupi i saj i bukur, vec Eda e dashur e mbush. Shkojmë nga shtëpia e saj e ma nxirr pak... Dua të më shohë kështu. (*Vështron veten.*)

Roland — Ç'tha babai përmua?

Valteri — Babai ka shkuar me shërbim, nuk është kthyer ende. Po ti rri i qetë, sa të më kesh mua, çdo gjë si në vaj.

Roland — Nuk është kthyer?

Valteri — Jo... ç'ke? C'më hap sytë kështu? Në telefon nuk bisedohen këto punë.

- Rolandi — Po ti ishte mbrëmë bashkë me të.
- Valteri — Je në vete? Mos kë parë ndonjë ëndërr.
Se në fakt, që kur hyre, m'u duke pak si i shkalluar.
- Rolandi — Unë i shkalluar? Po unë të pashë me këta sy!
- Valteri — Ndonjë natë tjetër po, po jo mbrëmë, mor shpirt.
- Rolandi — (Thérret.) Coli, Coli! (*Hyn djali i vogël që qëndron te dera.*) Pyete! (Valterit) Pyete vetë.
- Valteri — S'është nevoja... Për çfarë ta pyes?...
Po, or, katundar, ç'kemi nga fshati?
- Coli — (Lojë) Si the?
- Valteri — Ç'kemi nga fshati?
- Coli — Ka humbur një gomar! (Valteri turret ta kapë, po i del Rolandi përpara).
- Rolandi — S'ke punë me të, po më thuaj mua të vërtetën.
- Valteri — Mos më mërzit tepër tanë, të thashë që babai s'është kthyer ende nga shërbimi.
- Coli — Gënjeshtar. (Rolandi e mbërthen, Valteri mundohet të shkëputet.)
- Rolandi — Dil jashtë, jashtë po të them.
- Valteri — Ja... La... ndi...
Rolandi — Zhduku. (*I hedh golfin, ndërkohë hyn Fatosi që e ndesh Valterin te dera.*)
- Fatosi — I shkreti ti. (Duke i kapur golfin.) Këto, këto mund t'i kesh me shumicë, veç, ama, zemrën e ke tepër, tepër të varfër. Ne na ke parë si dashnorë, po je gabuar, ne jemi vetëm shokë dhe miq. Kjo është pasuria jonë. Kjo është pastërtia jonë. (Hynë 'Besniku dhe

Astriti. Valteri largohet. Ndërsa Rolandi shkon te dollapi i vet dhe fillon të mble-dhë plaçkat.)

Besniku — Roland, ç'bën ashtu? (Rolandi në hesh-tje vazhdon veprimin, shokët shohin njëri-tjetrin të habitur. Besniku i afrohet.) Ç'bën, të pyeta!

Rolandi — Do të iki.

Besniku — Ku, ku këshfu?

Rolandi — Më lër, Besnik.

Besniku — Ti ke ardhur për shkollë, apo...

Rolandi — Për aventura, pse s'thua!

Besniku — Ulu, ulu e rri aty.

Rolandi — Thashë do të iki dhe mbaroi.

Astriti — Roland, (Ai vazhdon të mbledhë plaçkat, Astriti i afrohet dhe i mban çantën.) a s'po e dëgjon se ç'thotë?

Rolandi — Më lër, Astrit.

Astriti — Mos bëj marrëzira.

Fatosi — Landi, edhe dy javë na kanë mbetur. Ti mezi pritke të ndahesh nga ne?

Rolandi — Ah! (Ulet.) Jo, e kam të pamundur, Astrit, letrën në librin e Edës a e di kush e vuri? Asnjeri nuk e di: unë e vura, unë.

Fatosi — Si, çfarë? Ti e fute letrën? (Gjendja e nderë.)

Rolandi — C'më rrini ashtu? Ç'prisni, më qëlloni, më pështyni, eh, Fatos!

Fatosi — Kjo është e pabesueshme.

Besniku — Cudi.

Rolandi — Besnik...

Fatosi — E poshtër, e poshtër.

Besniku — (Rolandit) Dhe e kë mbajtur kaq kohë?

Po a e kupton, a e ndien se ç'poshtërsi ke bërë (*Rolandi tepër i pezmatuar*), ngrije kokën.

Rolandi — Nuk mundem, nuk kam fytyrë.

Astriti — Roland, ky eshtë një veprim i fëlli-qur. Kurrë s'ma priste mendja se mund të shkoje deri këtu... (*Bën më tutje.*) Mjaft u quravite, nëse e bëre dhe e ndien, ki kurajë dhe shikoji shokët në sy

Rolandi — (*Ngre kokën me mundim.*) Ç'të të them tjetër, Astrit, e bëra.

Fatosi — Turp!

Astriti — Sikur të ishte vetëm ajo.

Rolandi — Astrit...

Astriti — Fola më tepër pér vete.

Fatosi — C'do ti, pse kërkon të përzihesh kot?

Astriti — Desha të them se Eda e quajti paçavure atë letër dhe paska pasur të drejtë.

Besniku — Edhe më keq, edhe më ndyrë ta quante.

Astriti — Megjithatë, ç'ngjau e ç'ndodhi nuk erdhi vetëm prej saj... Prit, Fatos, nuk dua të shfajësoj Rolandin, jo, aspak, por dua t'i them vetes, vetes edhe ty, Roland, a e sheh në ç'batak, në ç'llum kishim rënë? Këtë kurërë s'kam pér ta harruar. E një tyryfyl si Valteri na térhoqi prej hundësh, na mash-troi.

(*Hyn Agimi vrullshëm.*)

Agimi — Astrit, Eda të kërkon në telefon.

Fatosi — Eda! Jo, po s'them kot pér të se ç'vajzë e mrekullueshme eshtë.

Astriti — Shko ti, Fatos, shko...
Agimi — Ajo të kërkon ty, Astrit. Kishte merak nëse je në dhomë apo jo. Unë ngula këmbë dhe i thashë këtu është, por ajo...
Astriti — Kishte merak për mua. Kulmi! Ajo ende vazhdon të interesohet, ende bëhet merak për mua, ndërsa unë, unë... jo, e kam të pamundur, nuk mund të shkoj... shko, Fatos, shko, të thashë... Duhet ta meritosh miqësinë e saj, ta meritosh mirë bile... dhe unë..., unë nuk e meritoj... Ç'më shihni ash-tu, ë? Flisni! (Pauzë)

Roland — Astrit... këtë duhet ta them unë...
Jo vetëm miqësinë e saj, por edhe tuajën, edhe të tjerëve... Ti ç'ke, Astrit, unë..

Besniku — Roland, mjafth tani. Hajde, Astrit, nisu,

Astriti — Shko, pra, Fatos.

Fatosi — Duhet të shkosh ti, Astrit.

Astriti — Ç't'i them më parë. S'mjafton një bisedë në telefon. Kam shumë gjëra për t'i thënë.

Pamja e pestë

Veprimi në ambient të hapur. Shumica e nxënësve e ka dhënë provimin dhe janë në humor, nga brenda vjen Vjollca.

Vjollca — Po përgjigjet Eda.

Fatosi — Po Astriti?

Drita — Qaj hallin e Astritit ti, ti, mor qyq, nuk iu ndave tetës.

Vjollca — Tetë me «T» të madhe, ama.

Fatosi — Të faleminderit, Vjollca. Tani diçka tjetër dua prej teje. (*I zgjat një fletore.*) Më lër një kujtim këtu.

Vjollca — Me mua do ta nisësh.

Fatosi — Këtë nder ia kam bërë tjetërkujt.

Mira — Syve bojë qelli. (*Me humor*) Vajzë e thjeshtë me sy...

Vjollca — Ah, Dritëz, po ma jep ta lexoj.

Mira — Sekret.

Fatosi — Poshtë sekretet ndaj njëri-tjetrit! Urdhëro, lexoje.

Vjollca — (*E merr dhe e lexon.*) Fatos!

Fatosi — Urdhëro.

Vjollca — Prit. (*Lexon.*), Fatos, ti për mua ke qenë e do të mbetesh një shok i mrekullueshëm, njeriu më i sinqertë, njeriu më i mirë... O, nuk u shtyka më tutje; pompa, pompa, fryrje. Si ka mundësi që s'paska qoftë dhe një të metë.

Agimi — (*Nga larg*) Ka, edhe të metë të madhe, bile.

Drita — Që nuk e përvetësoi anglishten si ti...

Agimi — Më vjen keq, s'jam egoist. Por, ama, të metën nuk ia fsheh dot

Fatosi — Nxirre, të shkretën.

Agimi — Preshi,

Fatosi — Preshi?

Agimi — Ky, shokë e shoqe, nuk e ka pasur qejf sallatën me presh. Sa herë do të kishim gjellë të tillë, shkonte e mbushte xhepat me hallvë.

(*Hyn Lumi.*)

Lumi — Ua, ç'bëni ju?

Vjollca — E dhanë provimin këta, po ti ç'u bëre?

Lumi — Po ti, Vjollca, e dhe?

Vjollca — Vetëm dy ke brenda: Eda dhe Astriti!

Lumi — Uaaa, Vjollca, xhani i motrës; do të mbetëm, asgjë, asgjë nuk mbaj mend. Me të hyrë në oborrin e shkollës, ç'kisha mësuar më fluturoi. (*Bën të ikë.*)

Fatosi — Lumi, para se t'ia mbathësh, shkuaj këtu.

Lumi — Më lër, Fatos, unë po dridhem e ti...

Agimi — Kështu bëre dhe në dy provimet e para ti, por, ama, i vdiqe dy nëntat.

Lumi — Uaaa! (*Kthen kokën andej-këndej dhe tho-*

të mësimin.) Poetët, poetët e antikitetit shkruanin...

Fatosi — (*E ndërpret.*) Me stilograf!

Lumi — Si, si? Aman, hiqmani këtej, se më luajti fare.

Vjollca — Po ti hidhi dy fjalë në atë fletore.

Lumi — (*Merr fletoren në dorë.*) Ç'farë të shkruaj?

Fatosi — Ç'të duash... Më shaj, më thuaj je shok i keq, je fantaksuar.

Lumi — Uaaa, po pse të të shaj?

Fatosi — Atëherë më lavdëro!

Lumi — Po pse të të lavdëroj?

Fatosi — Epo, më vrisni!

Lumi — Prit, prit të jap provimin një herë.

Agimi — Rro, Fatos, rro shumë-shumë dhe nja gjashë-shtatë minuta.

Lumi — (*Që s'e ka mendjen.*) Kush tha shtatë, kush mori shtatë?

Vjen drejt tyre mësues Bardhi.

Bardhi — Ka të tjerë? (*Lumit*) Vetëm ti je?

Lumi — Është dhe mamaja.

Bardhi — Mamaja, ku është mamaja?

Lumi — Te rruga. (*Të qeshura*)

Bardhi — Ku janë të tjerët? Ç'bëjnë ata shokët e komisionit të mbrëmjes?

Agimi — Në veprim, profesor.

Del Eda.

Eda — (*E gëzuar, bën një veprim.*)

Vjollca — Fol, hape.

Eda — Dhjetë. (*E përqafon.*)

Fatosi — Po Astriti si dukej?

Eda — Pyetja 25 i ka rënë

Fatosi — Bobo, më e vështira!

(Pranë derës rri Lumi, jep e merretë hyjë
apo të mos hyjë. Shokët i afrohen ngadalë
dhe i shtyjnë miqësisht. Fiken dritat.)

Veprimi kalohet në një mjedis tjetër, mjedis
vallëzimi. Dikush ulur dhe dikush pranë orkestrës
ose magnetofonit. Një grup luajnë «biss», të qe-
shurë; në mes është Rolandi, i cili sapo është që-
lluar me pëllëmbë; hapet rrethi dhe ai i hedh sytë
të gjejë atë që e qëlloi e, pastaj miqësisht e me
humor, thotë:

Rolandi — Nuk e gjekam dot... Vazhdoni... Sikur
mai paska qejfi të ha pak dru

Të qeshura. Hyn Bardhi.

Bardhi — More, Fatosi, Fatosi, ku është se na ranë
këmbët.

Fatosi — Urdhëro, profesor, këtu jam.

Bardhi — Pa afrohu, ç'bëre për fjalën e rastit?

Fatosi — Gati. Nxjerr një letër dhe e lexojnë së
bashku.

Të dashur nxënës...

Bardhi — Jo, or, jo

Fatosi — Të dashur.. spektatorë...

Bardhi — Tjetër, tjetër.

Fatosi — Shkallët e stadiumit...

Bardhi — Ç'stadium, more, po gjej një hyrje të
mirë të thashë.

Fatosi — Të dashur mbrëmjetarë...

Bardhi — Mbrëmjetarë? Për nder, ju që merreni
me letërsi bëni çudira. Rri se po sajoi vetë
diçka.

Fatosi — Mos u lodh kot, profesor. (Ndërkohë drejt
tyre vijnë dy vajza që i stojnë në vallëzim.

Po atë çast dalin Eda me Astritin duke kërcyer dhe, diku më tutje, Rolandi sepse ngrron.)

Eda — Ja dhe mbrëmja e fundit. Çudi si ikën kater vjet.

Astriti — Sikur tē ishin katér ditē.

(Afrohet Rolandi disi i pezmatuar.)

Eda → Roland, ne kemi qenë shokë, dhe duhet tē mbetemi shokë e miq.

Astriti — Ti e respekton dhe di ta mbrosh këtë ndjenjë, Eda.

Eda — Dy fjalë, vetëm dy fjalë të thjeshta janë, por me kuptim të madh. (Ndërkaq humbet edhe ajo ndërmjet vallëzuesve.).

Fundi i dramës

PËRMBAJTJE

Pamja e parë	5
Pamja e dytë	21
Pamja e tretë	36
Pamja e katërt	49
Pamja e pestë	56